

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR LANDFILLET E MBETJEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi synon të krijojë një kuadër ligjor të qartë dhe të zbatueshëm për landfillet e mbetjeve, në përputhje me zhvillimet e fundit rregullatore në Bashkimin Evropian, me ndryshimet e mëvonshme përfshirë ato të vitit 2024, të Direktivës së Këshillit 1999/31/EC të 26 prillit 1999 për landfillin e mbetjeve.

Projektvendimi synon të përcaktojë kushtet dhe kërkesat për projektimin, ndërtimin, funksionimin dhe mbylljen e landfilleve, kriteret për pranimin dhe përjashtimin e mbetjeve në kategoritë e ndryshme të landfilleve, kërkesat për reduktimin progresiv të asgjësimit të mbetjeve në landfill, me qëllim nxitjen e përgatitjes për ripërdorim, riciklimit dhe proceseve të tjera të rikuperimit për të mundësuar tranzicionin nga një ekonomi lineare në një ekonomi qarkulluese.

Për këtë qëllim, në projektvendim përcaktohen afatet dhe objektivat për pakësimin e mbetjeve të biodegradueshme që depozitohen në landfill si dhe objektivat dhe afatet për zvogëlimin e depozitimit të mbetjeve bashkiake në landfill.

Kërkesat e projektvendimit synojnë parandalimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës, ajrit dhe mjedisit në tërësi, përfshirë ndikimet klimatike dhe rreziqet për shëndetin e njeriut gjatë ciklit të jetës së landfillit, nëpërmjet masave dhe procedurave të dedikuara për të parandaluar efektet e sipërpërmendura.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektakt është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2026 dhe vjen si detyrim i zbatimit të dispozitës ligjore, pikave 1, 7 dhe 9 të nenit 34, pika 4 e nenit 35, pika 4 e nenit 36, dhe nenin 80, të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Projektakti është në përputhje edhe me Vendimin nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020-2035”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektakti i propozuar synon të përmirësojë ndjeshëm kuadrin rregullator për projektimin, ndërtimin, funksionimin dhe mbylljen e landfilleve, duke i kushtuar rëndësi të veçantë reduktimit progresiv të depozitimit të mbetjeve, veçanërisht atyre që janë të përshtatshme për riciklim, ripërdorim apo trajtime të tjera. Një nga përparësitë kryesore është përcaktimi i objektivave ambiciozë, në përputhje me kërkesat e BE-së për menaxhimin e mbetjeve në përgjithësi dhe landfilllet, për reduktimin e mbetjeve biodegradueshme dhe mbetjeve të tjera të depozituara në landfill, që reflektojnë angazhimin për kalimin drejt një ekonomie qarkulluese dhe zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve.

Për më tepër, projektvendimi thekson rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit publik dhe mjedisit nga ndikimet negative të landfilleve, duke ndaluar landfillimin e mbetjeve të patrajuara ose të riciklueshme, me përjashtim të rasteve kur trajtimi në landfill siguron rezultatin më të mirë mjedisor, në përputhje me standardet më të larta të BE-së.

Nga ana tjetër, ky projektvendim adreson problematikat e evidentuara në praktikën e deritanishme, duke përmirësuar dhe qartësuar procedurat për pajisjen me leje mjedisi, operimin dhe mbylljen e landfilleve, si dhe kontrollin dhe

monitorimin e tyre. Përmes përcaktimit të kushteve të detajuara dhe garancive financiare për operatorët, përmirësohet transparenca dhe përgjegjshmëria në menaxhimin e mbetjeve. Një risi e rëndësishme është gjithashtu ndryshimi i strukturave përgjegjëse për shqyrtimin e planeve të përmirësimit të venddepozitimeve ekzistuese, duke zhvendosur kompetencat nga Komiteti Ndërmnistror i Mbetjeve, një strukturë e cila nuk ekziston më në kuadër të ndryshimeve institucionale aktuale, tek AKEM sh.a, çka synon efikasitet më të madh dhe koordinim më të mirë institucional në menaxhimin e mbetjeve. Këto masa adresojnë sfidat e zbatimit të politikave mjedisore në vend, duke përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e sistemit të landfillleve.

Efektet e pritshme të këtij projektvendimi janë multidimensionale dhe të rëndësishme për mjedisin dhe shëndetin publik. Përmes reduktimit të mbetjeve që depozitohen në landfill, rritjes së riciklimit dhe përgatitjes për ripërdorim, do të ulet ndotja e tokës, ujërave dhe ajrit, dhe do të minimizohen rreziqet për shëndetin publik. Objektivat afatgjata, si reduktimi në 10% i sasisë së mbetjeve të depozituara në landfill deri në vitin 2045, janë në linjë me standardet e BE-së dhe synojnë një transformim të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, në përputhje me nenin 20 të këtij vendimi, i cili përcakton ndalimin progresiv të depozitimit të mbetjeve të riciklueshme dhe arritjen e kufirit 10% deri në vitin 2045..

Gjithashtu, përmirësimi i rregullave për lejet mjedisore dhe monitorimin e vazhdueshëm do të sigurojë një kontroll më rigoroz dhe përgjegjshmëri më të madhe nga ana e operatorëve, duke garantuar që landfillet të menaxhohen në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme në përputhje me direktivat e BE-së për mbetjet dhe landfillet. Në këtë mënyrë, ky projektvendim synon jo vetëm të plotësojë kërkesat ligjore, por edhe të kontribuojë në zhvillimin e një infrastrukture mjedisore efikase dhe të qëndrueshme në Shqipëri.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës dhe pikave 1, 7 dhe 9 të nenit 34, pika 4 e nenit 35, pika 4 e nenit 36, dhe nenin 80, të ligjit nr. 57 datë

16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Gjatë përgatitjes së projektaktit, janë analizuar edhe parashikimet e:

- Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 26.6.2019 “Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe të kriterëve specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 06.03.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim ka si synim të përafrojë direktivën e Këshillit 1999/31/EC të 26 prillit 1999 për landfillin e mbetjeve (OJ L 182 16.7.1999, p. 1), dhe vendimin e Këshillit 2003/33/EC të 19 dhjetorit 2002, (32003D0033), i cili vendos kriteret dhe procedurat për pranimin e mbetjeve në landfill, në zbatim të nenit 16 të shtojcës II të direktivës 1999/31/EC (OJ L 182 16.7.1999, p. 1). Ky projektvendim përafrohet po ashtu Vendimin Zbatues të Komisionit (BE) 2019/1885, të 6 nëntorit 2019 mbi përcaktimin e rregullave për përlogaritjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave mbi landfillet e mbetjeve, në përputhje me direktivën e Këshillit 1999/31/EC të 26 prillit 1999 për landfillin e mbetjeve,.

Ky relacion shoqërohet edhe nga tabela e përputhshmërisë së projektvendimit me aktet e sipërcituara të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është organizuar në 9 krerë, 23 nene dhe shtojcat përkatëse, të cilat parashikojnë vendosjen e kërkesave për projektimin, ndërtimin, funksionimin dhe mbylljen e landfilleve, mbylljen e venddepozitimeve të paligjshme, pranimin e mbetjeve në landfille si dhe kërkesat për reduktimin progresiv të asgjësimit të mbetjeve në landfill, vecanërisht të mbetjeve të cilat janë të përshtatshme për riciklim, përgatitje për ripërdorim apo rikuperime të tjera, dhe të mbetjeve bio.

Në kreun e parë trajtohen dispozitat e përgjithshme të projektvendimit, të cilat përcaktojnë objektin e projektvendimit, përkufizimet e termave të përdorur në projektvendim, fushat e zbatimit, duke vendosur theksin në rëndësinë e parandalimit të efekteve negative në shëndet dhe në mjedis nga asgjësimi i mbetjeve në landfill, si dhe rëndësinë për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, duke ndaluar depozitimin në landfill të mbetjeve të patrajtuara, apo të mbetjeve të cilat janë të përshtatshme për riciklim apo rikuperime të tjera.

Gjithashtu, në kreun e parë jepen përkufizimet e termave të përdorura në projektvendim, të cilat janë të harmonizuara me ato të përdorura në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si dhe me ato në Direktivat e BE-së, përkatësisht Direktivën Kuadër të Mbetjeve dhe Direktivën e Landfilleve. Po ashtu, në këtë kre përcaktohet fusha e zbatimit e projektvendimit, e cila është harmonizuar plotësisht me amendimin e fundit të bërë në Direktivën e Landfilleve në vitin 2018.

Në kreun e dytë përcaktohen kërkesat të cilat duhet të plotësohen për të gjitha landfillet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në përputhje me Direktivën e Landfilleve, landfillet ndahen në 3 kategori: landfillet për mbetjet e rrezikshme, landfillet për mbetjet jo të rrezikshme dhe landfillet për mbetjet inerte.

Më tej, një risi e vendimit është neni 5, ku listohen mbetjet dhe trajtimet të cilat janë të përjashtuara nga landfillet, me dispozitat e përditësuara sipas amendimit të Direktivës së Landfilleve në 2018, ku ndër mbetjet e përjashtuara nga landfillet, janë shtuar mbetjet të cilat janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar për ripërdorim dhe riciklim, me qëllim zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, rritjen e

qarkullimit të mbetjeve në sistem dhe reduktimin e mbetjeve që dërgohen për asgjësim në landfill, me përjashtim të rasteve kur trajtimi në landfill siguron rezultatin më të mirë mjedisor.

Neni 6 liston mbetjet dhe trajtimet që pranohen në landfille, duke theksuar rëndësinë e marrjes së masave që nxisin rritjen e përgatitjes për ripërdorim dhe riciklim, zbatimin e hierarkisë së mbetjeve dhe mbështetjen e objektivave të përcaktuara në ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” .

Në kreun e tretë të vendimit detajohen dispozitat të cilat lidhen me lejet e mjedisit për landfillet e mbetjeve. Kreu III është ristrukturuar dhe nenet janë titulluar në përputhje me nenet përkatëse në Direktivën e Landfilleve, në mënyrë që të ndiqet rrjedha logjike e procesit të pajisjes me leje mjedisi për një landfill.

Neni 8 “Kërkesa për leje mjedisi” i cili detajon procedurën që duhet ndjekur nga aplikanti për pajisjen me leje mjedisi për një landfill, informacionet e detajuara teknike që kërkesa duhet të përmbajë si dhe metodat e planet e propozuara për operimin, monitorimin, kontrollin, mbylljen e landfillit dhe të kujdesit pas mbylljes, po ashtu edhe informacion mbi garancinë financiare që parashikohet nga legjislacioni për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

Neni 9 “Kushtet që duhen plotësuar për pajisjen me leje mjedisi” i cili detajon procedurën që duhet ndjekur dhe kriteret që Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet të analizojë gjatë një aplikimi për leje mjedisi në mënyrë që të lëshojë lejen e mjedisit, të tilla si plotësimi i kërkesave të legjislacionit shqiptar për menaxhimin e mbetjeve dhe për landfillet, masat e parashikuara për parandalimin e aksidenteve dhe kufizimin e pasojave të aksidenteve, kapacitetet teknike dhe menaxheriale të drejtuesit teknik si dhe marrja e masave nëpërmjet garancisë financiare e cila siguron plotësimin e detyrimeve gjatë operimit të landfillit por edhe pas mbylljes së landfillit;

Neni 10 “Përmbajtja e lejes së mjedisit për landfillin” përmban të gjitha informacionet që duhet të përmbajë një leje mjedisi për landfillin në momentin që leja e mjedisit miratohet. Leja e mjedisit për landfill përmban të gjitha informacionet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit, si dhe informacionin dhe kërkesat e listuara në nenin 10, të cilat janë specifike dhe të hartuara posaçërisht për teknikalitetet e landfilleve.

Kreu i katërt mbi Operacionet e Landfilleve, përbëhet nga tre nene. Në këtë kre së bashku me shtojcat përkatëse (Shtojca II dhe Shtojca III) përcaktohen procedurat dhe rregullat për mbetjet e pranuar në landfill, kontrolli dhe vetëmonitorimi nga ana e Operatorit të landfillit në mënyrë që të parandalojë dëmet e mundshme në mjedis, si edhe kriteret dhe procedurat për mbylljen e landfillit dhe kujdesit afatgjatë pas mbylljes.

Në nenin 11 përcaktohen procedurat e pranimit të mbetjeve në landfill duke ndarë detyrat midis zotëruesit të mbetjeve dhe Operatorit të landfillit, lloji i dokumentacionit shoqërues, mënyra e verifikimit si edhe regjistrimet përkatëse. Procedura dhe kriteret e pranimit të mbetjeve në landfill janë gjithashtu shumë të detajuara në Shtojcën II, duke qenë në përputhje të plotë me rregullat dhe kriteret e BE sipas përcaktimeve të nenit 6 të Direktivës së Landfillit (përfshirë rastet e vecanta të disa mbetjeve të rrezikshme, si merkuri i lëngshëm).

Në nenin 12 “Kontrolli dhe procedurat e vetëmonitorimit në fazën operationale”, përcaktohet detyrimi i operatorit për operimin në përputhje me licencën si edhe detyrimet për të njoftuar AKM në rast se vëren ndonjë rrezik të mundshëm ndaj mjedisit. Në Shtojcën II, përcaktohen llojet e vetëmonitorimit dhe frekuenca e tyre si edhe raportimet përkatëse pranë AKM.

Në nenin 13, trajtohen procedurat e mbylljes së landfillit si dhe hapat që ndiqen, që nga vizita dhe raporti teknik nga ana e AKM, miratimi nga ana e Ministrisë të mjedisit për mbylljen dhe kushtet që duhen plotësuar. Mbyllja e landfillit bëhet sipas kushteve të mirëpërcaktuara dhe kujdesit të detyrueshëm për një periudhë të paktën 30 vjecare dhe kundrejt sigurimit të mjeteve monetare të nevojshme. Operatori i landfillit është përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njerezve edhe gjatë periudhës së mbylljes, deri sa AKM vendos se aty nuk ka më rrezik nga gazrat, ujërat kulluese, ujrat nentokësore dhe rreziqe të tjera.

Në kreun e pestë të vendimit, i cili përbëhet nga neni 14 dhe neni 15, përcaktohen dispozitat për venddepozitimet ekzistuese të mbetjeve. Në nenin 14 përcaktohet procedura që duhet ndjekur nga operatori i një venddepozitimi ekzistues, që të mund të vazhdojë operimin e venddepozitimit, nëpërmjet paraqitjes së një plani përmirësimi i cili i dorëzohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, e cila vendos mbi pajisjen me leje të re mjedisi për venddepozitim ekzistues, ose mbylljen e tij. Në përputhje me Planin e Zbatimit të Direktivës Specifike për Landfillin, afati për të paraqitur këtë plan pranë AKM-së është data afatet e përcaktuara në periudhën

tranzitore, në përputhje me DSIP dhe planin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve. Risi në këto dispozita është heqja e Komitetit Ndërministror të Mbetjeve si strukturë që shqyrton planin e përcjellë pas miratimit nga AKM.

Neni 15 i projektvendimit, i kombinuar me Shtojcën VII të projektvendimit, përcakton procedurat dhe kërkesat për mbylljen e venddepozitimeve të paligjshme të mbetjeve, të cilat janë krijuar historikisht gjatë viteve. Ky nen, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 57/2025 “për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, përcakton dhe përballimin e kostove për mbylljen e venddepozitimeve të paligjshme dhe rehabilitimin e këtyre mjedisëve, si dhe ndarjen e përgjegjësive institucionale ndërmjet Ministrisë së mjedisit, bashkive, AKEM sh.a dhe AKM në këtë proces.

Kreu i gjashtë përbëhet nga nenet 16, 17 dhe 18, mbi kostot, tarifat dhe garancitë financiare për landfillet e mbetjeve, dhe përcakton elementët që tarifa e përcaktuar nga operatori për asgjësimin e mbetjeve në landfill duhet të mbulojë, konkretisht kostot e projektimit, operimit, kostot e garancisë financiare, si dhe kostot që vlerësohen për mbylljen dhe kujdesin e mëtejshëm pas mbylljes së landfillit, për të paktën një periudhë prej 30 vitesh pas mbylljes së landfillit. Të gjitha dispozitat e këtij kreu përbëjnë risi në projektvendim, duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Direktivës së Landfillit lidhur me kostot, tarifat dhe garancitë financiare.

Këto nene bëjnë qartësisht ndarjen midis dy garancive financiare që operatori i landfillit duhet të sigurojë: garancisë financiare për operimin e landfillit, e cila mbulon kostot që lidhen me raste të tilla si falimentimi i operatorit, shkelja e rëndë e kushteve të lejes së mjedisit, dështimi për të kryer mbylljen brenda afatit ose ndotja e rëndë që kërkon ndërhyrje të menjëhershme, si dhe garancisë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillit, e cila mbahet për çdo qelizë që është në operim dhe fillon të përdoret në momentin që qeliza përkatëse plotëson kapacitetin e saj. Kjo garanci mbulon kostot për mbylljen përfundimtare teknike të qelizës përkatëse, monitorimin dhe kujdesin pas mbylljes për një periudhë jo më të shkurtër se 30 (tridhjetë) vjet, rehabilitimin mjedisor, si dhe ndërhyrjet emergjente në rast rreziku për mjedisin dhe shëndetin publik pas mbylljes së landfillit.

Po ashtu, në projektvendim janë parashikuar edhe shtojcat VIII dhe IX, të cilat mbulojnë, respektivisht, metodologjinë dhe formulën për llogaritjen e garancisë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes, si dhe dokumentacionin e

nevojshëm për vendosjen e garancisë financiare dhe procedurat për përdorimin e saj për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillit. Kreu i shtatë përcakton objektivat dhe afatet për asgjësimin e mbetjeve në landfill si dhe rregullat për përlllogaritjen e arritjes së objektivave. Ky kre përbëhet nga nenet 17, 18 dhe 19.

Në nenin 19, “Pakësimi i mbetjeve biodegradueshme që depozitohen në landfill”, përcaktohen objektivat e ndërmjetme për reduktimin e këtyre mbetjeve. Konkretisht, parashikohet që brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, sasia e mbetjeve biodegradueshme që depozitohen në landfill të reduktohet në 50% të sasisë së mbetjeve biodegradueshme të prodhuara në vitin 2010, ndërsa brenda 10 vjetëve kjo sasi të reduktohet në 35% të sasisë së mbetjeve biodegradueshme të prodhuara në vitin 2010.

Në Nenin 20 mbi “Objektivat e zvogëlimit të mbetjeve që depozitohen në landfille”, përcaktohen objektivat e ndërmjetme të sasisë totale të mbetjeve që depozitohen në landfille me qëllim që në vitin 2045 vetëm 10% e mbetjeve të depozitohet në landfill. Ky objektivi është një risi e Direktivës së Landfillit të vitit 2018, dhe është reflektuar në këtë projektvendim me qëllim transpozimin e Direktivës në legjislacionin shqiptar. Në kuadër të përgatitjes së Planit të Zbatimit të Direktivës Specifike për Landfillët, afatet e përcaktuara në vendim janë të harmonizuara me periudhat e parashikuara në Planin e Zbatimit.

Pas datës 31 Dhjetor 2035, mbetjet e patrajtuara më parë, si dhe mbetjet e përshtatshme për riciklim dhe rikuperime të tjera, nuk pranohen në landfill. Gjithashtu, nenet 5 dhe 6, për mbetjet dhe trajtimet që pranohen dhe nuk pranohen në landfille, përcaktojnë parimet dhe kërkesat për pranimin dhe përjashtimin e mbetjeve dhe trajtimeve në landfille, konkretisht për mos pranimin në landfill të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar për ripërdorim, riciklim apo rikuperime të tjera dhe mbetjeve të patrajtuara, dhe neni 21 vendos datën përfundimtare nga e cila fillon ky përjashtim nga landfillët. Deri në atë datë, politikat dhe aktet ligjore duhet të orientojnë menaxhimin e mbetjeve në mënyrë që sasia e mbetjeve që depozitohet në landfill të jetë sa më e vogël.

Neni 21 i këtij Kreu mbi “Rregullat e përlllogaritjes së arritjes së objektivave” është një risi e projektvendimit, dhe transponon nenin 5a të Direktivës së Landfillit, po ashtu dhe Vendimin Zbatues të Komisionit (EVE) 2019/1885, ku përcaktohen parametrat që do të merren në konsideratë sipas rasteve, për të monitoruar nëse objektivat janë arritur. Dispozitat përcaktojnë rastet kur mbetjet bashkiake të depozituara në landfill konsiderohen si të tilla dhe specifike kur

mbetjet bashkiake eksportohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për qëllime depozitimi në landfill, ato përlllogariten në sasinë e mbetjeve të depozituara në landfill në territorin ku janë krijuar, pra në Shqipëri. Po ashtu, përcaktohet rasti kur mbetjet e krijuara pas operacioneve të riciklimit ose rikuperimeve të tjera të mbetjeve bashkiake, të cilat më pas depozitohen në landfill, nuk përfshihen në peshën e mbetjeve bashkiake të raportuara si të depozituara në landfill.

Kreu i tetë përbëhet nga një nen dhe përmban dispozitat për raportimet që duhen kryer lidhur me zbatimin e këtij vendimi në tërësi dhe me arritjen e objektivave të përcaktuar në nenet 20 dhe 21 të vendimit, që kanë të bëjnë me zvogëlimin e depozitimit të mbetjeve në landfill.

Kreu i nëntë përbëhet nga neni 23 mbi dispozitat përfundimtare, në të cilin përcaktohet shfuqizimi i Vendimit nr. 452, datë 11.7.2012, “Për landfillet e mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe i Udhëzimit nr. 1738, datë 12.03.2015, “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfillleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”. Gjithashtu, në këtë nen përcaktohet hyrja në fuqi e këtij vendimi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Projektvendimi përmban edhe 9 shtojca bashkëlidhur, të cilat përshkruajnë kërkesat teknike dhe mjedisore për projektimin, ndërtimin, operimin, monitorimin, mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillleve, kriteret dhe procedurat për pranimin e mbetjeve në landfill, procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit, metodologjinë për llogaritjen e garancive financiare, dokumentacionin dhe procedurat për administrimin e tyre, si dhe kërkesat specifike për regjimin operacional të landfillleve ekzistuese, me qëllim garantimin e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut në përputhje me standardet e legjislacionit kombëtar dhe acquis të Bashkimit Evropian.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen:

Ministria përgjegjëse për mjedisin, AKEM sh.a, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, dhe Struktura Inspektuese përgjegjëse në fushën e mjedisit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektaktit kanë kontribuar ekspertë të ministrisë përgjegjëse për mjedisin në bashkëpunim me ekspertë të GIZ, në kuadër të projektit BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjellbër.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Infstrukturës, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infstrukturës dhe Energjisë Ministrinë të Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrinë për Pushtetin Vendor, Inspektoriatin të Përgjithshëm dhe Agjencisë Për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe më pas do të publikohet në portalin e konsultimit publik.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për landfillet e mbetjeve” është hartuar në përputhje me Planin e Zbatimit të Direktivës Specifike për Landfillet (DSIP), në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me Direktivën 1999/31/EC për landfillet e mbetjeve.

Zbatimi i këtij projektvendimi shoqërohet me kosto financiare, të cilat lidhen me përmbushjen e kërkesave teknike, mjedisore dhe operative për projektimin, ndërtimin, operimin, monitorimin, mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfilleve të mbetjeve.

Në përputhje me DSIP dhe me parimin “ndotësi paguan”, këto kosto nuk përballohen nga buxheti i shtetit, por mbulohen nga operatorët e landfilleve përkatëse, nëpërmjet tarifave të asgjësimit të mbetjeve, garancive financiare dhe mekanizmave të tjerë financiarë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Projektvendimi nuk parashikon krijimin e të ardhurave shtesë për buxhetin e shtetit, si dhe nuk sjell nevojë për alokim fondesh shtesë buxhetore për institucionet publike përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e tij.

Funksionet e kontrollit, inspektimit dhe monitorimit realizohen nga institucionet përgjegjëse ekzistuese, në kuadër të kompetencave dhe burimeve financiare të miratuara, pa krijuar detyrime të reja financiare për buxhetin e shtetit.

Në përputhje me DSIP, financimi i masave për zbatimin e Direktivës së Landfillit sigurohet përmes mekanizmave financiarë jashtë buxhetit të shtetit, duke garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian pa rritur barrën buxhetore publike.

MINISTËR

Sofjan JAUPAJ